



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMI I KURRIKULËS BËRTHAMË PËR SHKOLLËN E MESME TË
GJUHËVE TË HUAJA**

FUSHA: GJUHË E HUAJ

LËNDA: RUSISHT

KODI: 3.5.11.B

**PROGRAMI I LËNDËS
RUSISHT
PËR KLASËN E 11-të**

Koordinatori: ERIFILI HASHORVA

Redaktori: GAZMEND KRASNIQI

Përgjegjës sektori: MARITA HAMZA

TIRANË, KORRIK 2011

Programi i gjuhës ruse për klasën e 11-të është një dokument zyrtar dhe ka për qëllim të arrijë dhe të realizojë standartet e mësimdhënies, të mësim-nxënies dhe të vlerësimit të nxënësit, në nivelin gjuhësor A2, sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian për Gjuhët (në vijim KPER), duke mundësuar që nxënësi nga përdorues i nivelit A1 të gjuhës në klasën e 10-të të bëhet përdorues i nivelit A2 të gjuhës në përfundimin e studimeve në klasën e 11-të.

Programi i gjuhës ruse për klasën e 11-të, si pjesë përbërëse e kurrikulës së re të gjimnazit, lidhet harmonishëm dhe me programet ndërkurrikulare të kësaj klase, duke ndërthurur në mënyrë logjike dhe krijuese njohuritë e përfituara në gjuhën ruse me ato të lëndëve të tjera, si p.sh. në histori, gjeografi, letërsi etj. Kjo ndërthurje ndër-lëndore bëhet natyrshëm dhe e nxit nxënësin/en drejt punës së pavarur.

Programi përcakton kriteret e përmbushjes së standarteve të mësimdhënies/nxënies në përputhje me Portofolin Evropian të Gjuhëve të akredituar nga Këshilli i Evropës për nxënësit shqiptarë të gjimnazit. Zbatimi i standarteve është detyrë themelore e mësuesve dhe nxënësve, të cilët duhet të vlerësojnë se sa procesi mësimor përmbush objektivat e përgjithshme të kurrikulës kombëtare për gjuhët e huaja.

Programi përmbush nevojat dhe interesat gjuhësore e kulturore të nxënësit-/es, duke i ndërthurur ato me përvojat dhe dijet mbi botën që e rrethon, duke iu përshtatur grupmohës dhe duke nxitur në vazhdimësi zhvillimin e pavarur, intelektual dhe social-kulturor të nxënësit-/es.

Programi i gjuhës ruse për klasën e 11-të e drejton nxënës/in,-en :

- të mësojë në mënyrë të pavarur, duke i dhënë atij/asaj besim në vetvete në realizimin e detyrave në klasë e jashtë saj;
- të zhvillojë të menduarit kritik, duke i dhënë mundësi të konsultohet me më shumë burime informacioni dhe të bëjë përzgjedhjen e duhur personale;
- e përgatit nxënës/in,-en për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

1. SYNIMI I LËNDËS

Synimi i gjuhës së huaj në këtë fazë të formimit, është të pasurojë aftësitë e fituara në nivelin e mëparshëm, në mënyrë që nxënës/ i,ja të arrijë të konsolidojë nivelin A2, si niveli bazë i studimit të gjuhës së huaj.

Ky program duhet të sigurojë vijueshmërisë dhe thellimin e mëtejshëm të njohurive, shkathtësive e shprehive gjuhësore të nxënësve të këtij niveli.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Objektivat e përgjithshëm përcaktohen e detajohen sipas katër aftësive gjuhësore, fushave tematike dhe funksioneve gjuhësore. Ato janë të rëndësishëm për organizimin e procesit mësimor dhe vlerësohen nga mësuesi e vetë nxënësit. Për më tepër, parashtrimi i objektivave mundëson pavarësinë e nxënësve në procesin e nxënies.

Programi i gjuhës ruse për klasën 11- të ka si objektiva të përgjithshëm:

- të komunikojë saktë me shkrim dhe me gojë
- të jetë i aftë të dialogojë në situata të jetës reale

- të jetë në gjendje të bëjë dallimet ndërmjet kulturave të ndryshme;
- të jetë i aftë të ndërthur sa më mirë kategoritë e njohurive të përgjithshme me ato specifike në përputhje me shprehjet individuale të nxënësit.

3. OBJEKTIVA

a) Objektiva sipas standartit në komunikim

Përshkrimi: Objektivat e standarteve në këtë fushë zhvillojnë dhe thellojnë më tej bazat e gjuhës, si domosdoshmëri, për një komunikim me një standart më të lartë gjuhësor.

Nëpërmjet situatave të ndryshme gjuhësore, ky standart i mundëson nxënësit të thellojë njohuri gjuhësore të nevojshme, për të përballuar situata të komunikimit të përditshëm në gjuhën ruse.

	Objektiva
Komunikimi	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, nxënësi/-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të pyesë dhe të përgjigjet; • të hyjë në komunikim dhe të formulojë një thënie; • të shprehë pikëpamjet; • të prezantojë dhe të prezantohet; • të përcjellë informacion; • të kuptojë dhe të interpretojë një mesazh gjuhësor; në situata të ndryshme si : jeta e përditshme, jeta në shkollë; familja, koha e lirë, shoqëria etj; • të kryejë detyra të ndryshme në lojra, të cilat zhvillojnë aftësitë e komunikimit; • të kryejë detyra, që kërkojnë zgjidhje gjatë një monologu jo të komplikuar.
Veprimtaritë e komunikimit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, nxënësi/-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të prezantohet dhe të prezantojë ; • të falë dhe të kërkojë falje; • të miratojë; • të kundërshtojë; • të urojë; • të falenderojë; • të përsërisë një pyetje; • të kërkojë përsëritje të pyetjes; • të formulojë një pyetje; • të raportojë për një fakt apo një ngjarje; • të shprehë opinionin;

	<ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojë një person, fakt , ngjarje, veprim; • të raportojë për qëllimin e një veprimi ose të një ngjarjeje; • të bëjë hipoteza; • të shprehë pëlqime ose mospëlqime; • të shprehë dëshirë, qëllim, kërkesë, këshillë, propozim, keqardhje, falenderim, urim; • të kërkojë dhe të japë leje;në situata të jetës së përditshme si: festa,ditëlindje,në treg, në ekskursion, në bibliotekë, në poliklinikë, në farmaci, në rrugë , në restorant, në postë, në mësim, koha e lirë etj; • të përshkruajë me detaje një banesë; • të caktojë dhe të anullojë takime, duke shprehur qartë arsyen; • të komunikojë në situata jo të vështira, që kërkojnë një farë aftësie krijuese;
--	---

b) Objektivat sipas standartit në kulturë

Përshkrimi. Objektivat e standarteve në këtë fushë parashikojnë një shkallë më të lartë të ndërgjegjësimit kulturor, duke vënë theksin në administrimin e aftësive ligjërimore në ndërveprimin gjuhësor dhe kulturor.

	Objektiva
Kultura	<p>Në përfundim të klasës së 11-të,nxënësi/-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të njohë dhe të përdorë sipas regjistrave të gjuhës(normale,formale,informale) rregullat e mirësjelljes të popullit, në gjuhën e të cilit mëson; • të njohë dhe të flasë për monumentet e artit dhe të kulturës; • të njohë jetën, mënyrat e jetesës dhe traditat e popullit rus ; • të flasë për shijet e të rinjve, tregun, çmimet, modën ; • të njohë kinemanë, apo këngën ruse dhe të mund të bëjë komente për to ; • të komunikojë me një vizitor për të shkëmbyer informacion për familjen, miqtë.

c)Objektivat sipas standartit në formimin gjuhësor

Përshkrimi: Objektivat e standartit synojnë të aftësojnë nxënësin drejt prodhimit të elementeve gjuhësorë, që i përkasin nivelit A2. Nxënës/i,-ja nxitet të praktikojë struktura gramatikore të gjuhës ruse,si dhe të kuptojë lidhjen dhe përdorimin e saktë të tyre nëpërmjet situatave të ndryshme të ligjëritimit.

	Objektiva
Elementet gramatikore	<p>Në përfundim të klasës së 11-të,nxënësi/-ja aftësohet: të dallojë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të zgjedhojë; • të përdorë; • të lakojë në numrin njëjës dhe shumës; • të shkruajë; <p>(foljen e rregullt dhe të parregullt të zgjedhimit të parë dhe të zgjedhimit të dytë në kohën e tashme, të ardhme dhe të shkuarës të dëftores, foljen në mënyrën urdhërore, foljet kalimtare dhe jokalimtare, foljet e lëvizjes me parashtesa të ndryshme, numërorët rreshtorë dhe themelorë, përdorimi i tyre, përemrat vektorë, pyetës, pronorë,dëftorë , mohues)</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë saktë emrin në rase të ndryshme me dhe pa parafjalë dhe lakimin e veçantë të emrave të gjinisë femërore, asnjëanëse; • mbiemrin, (forma e plotë dhe e shkurtuar), përdorimi i tij në fjali; • ndajfoljen dhe përdorimin e saj sipas klasifikimit: ndajfoljet e vëndit, kohës, mënyrës, sasisë dhe cilësisë; ndajfoljet pyetëse; • ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë ; pjesorja dhe përcjellorja.

4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektiva
Të dëgjuarit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të,nxënësi/-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kuptojë temën e një diskutimi, që zhvillohet në praninë e tij, • të kapë pikën themelore të një lajmërimi ose të një mesazhi të shkurtër, të thjeshtë dhe të qartë; • të kuptojë frazat, fjalët dhe shprehjet që lidhen me fushat e interesit të tij të çastit, si : informacione për veten dhe familjen e tij, për vendbanimin, klasëne shkollën, shpjegimet si të shkojë në treg, për veprimtarinë që ai bën etj; • të kuptojë udhëzime, që i drejtohen atij ngadalë dhe me kujdes

	<p>dhe ndjek orientimet e shkurtra dhe të thjeshta;</p> <ul style="list-style-type: none"> të dëgjojë e të plotësojë ushtrime pa ndihmën e mjeteve vizive.
Të lexuarit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, nxënësi/-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> të dallojë informacionet kryesore në përmbledhjen e lajmeve apo të artikujve të thjeshtë të gazetave, kur janë të shkruara, të ilustruara të stukturuara qartë; të kuptojë një letër personale të thjeshtë, në të cilën letërshkruesi shkruan ose pyet për aspekte të ndryshme të jetës së përditshme; të kuptojë një korrespondencë apo mesazh të thjeshtë të shkruar nga shokët e tij ku lihet takimi, vendi dhe ora për të shkruar diku, si: në kinema, ndeshje etj; të orientohet të gjejë nëpër fletpalosje informacionet e dëshiruara për veprimtari jashtëshkollore, shfaqje ,ekspozita etj; të kuptojë mesazhet e thjeshta në kompjutër; të orientohet të gjejë informacionin që i nevojitet, p.sh: përmasat, çmimet e sendeve të ndryshme, duke iu hedhur një vështrim njoftimeve dhe reklamave; të kuptojë pa fjalor tekste jo të ndërlikuara, që kanë në përbërje material të mësuar dhe jo më shumë se 3-4 % fjalë të reja, të cilat mund të kuptohen lehtë sipas kontekstit ose duke bërë analizën fjalëformuese.
Të folurit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, nxënësi/-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> të fillojë, të vazhdojë dhe të mbyllë një bisedë të shkurtër; të tregojë një histori ose të përshkruajë disa gjëra me një listë të thjeshtë; të komunikojë atë, që ai kërkon të shprehë në një shkëmbim informacioni të kufizuar; të replikojë në grupe prej 2-3 ,ose më shumë personash. Kjo i jep atij mundësinë të shprehet personalisht për një tematikë të caktuar; të ritregojë tekstin me një farë modifikimi (të ndryshojë fillimin , ose fundin e tij, etj.); të tregojë se çfarë i pëlqen ose jo; të tregojë në mënyrë të thjeshtë një ngjarje; të përshkruajë veten apo familjen e tij, persona të tjerë, vendin ku banon.

Të shkruarit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, nxënësi/-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të mbajë shënime të shkurtra, të thjeshta dhe të dërgojë mesazhe të shkurtra për nevoja të çastit; • të shkruajë për jetën e tij të përditshme me shprehje dhe fjali të thjeshta (për njerëzit, vendet, punën ,shkollën, familjen, hobet, duke përdorur lidhëza të thjeshta, si, dhe, ose, sepse); • të shkruajë një recetë të thjeshtë kuzhine; • të plotësojë një pyetësor me të dhëna për veten, formimin e tij, interesat dhe dëshirat; • të paraqesë shkurtimisht veten në një letër me shprehje e fjali të thjeshta, duke treguar për familjen, shkollën, hobet; • të shkruajë një letër të shkurtër duke përdorur shprehje për përshëndetje, për të pyetur, për të falenderuar ose për të refuzuar dike; • të përdorë lidhëzat më të rëndësishme, për të treguar rendin kronologjik të ngjarjeve (në fillim, më pas, pastaj, në fund), • të formulojë pyetje rreth tekstit; • të jetë në gjëndje të përfundojë një tekst, kur është dhënë vetëm fillimi i tij; • të shkruajë një letër personale për të dhënë të rejat; • të marrë dhe të shkruajë një mesazh të shkurtër dhe të thjeshtë me kusht ,që të përsëritet dhe të riformulohet; • të shkruajë shifra, data, emra, kombësi, adresa, mosha, datëlindje etj.
---------------------	--

5. KËRKESAPËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i gjuhës ruse për klasën 11-të është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e gjuhës ruse. Ky program mbështet në dokumente të rëndësishme si:

- Kuadri i Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja.
- Kurrikula Kombëtare e Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar.
- Standardet e arritjes.

A. Objektivat.

Objektivat e parashtruara në programin e gjuhës ruse për klasën e 11-të janë të detyrueshme për t'u realizuar, si nga mësues/i,-ja, dhe autorët e teksteve. Të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj e njësi mësimore dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Meqënëse niveli i nxënësve brenda klasës është i ndryshëm, atëherë mësues/i,-ja ka nevojë të bëjë punë të diferencuar me nxënësit e tij/saj. Kjo kërkon që, përveç përcaktimit të objektivave të përgjithshëm të arritjeve, të përcaktojë edhe objektivat për nxënësit e nivelit të ulët, të nivelit mesatar dhe të nivelit të lartë.

B. Orët mësimore

Ky program është strukturuar sipas një formati të ri i cili jep për secilin standard fushe.

Në program janë përcaktuar gjithashtu objektivat për çdo aftësi, për të cilat mësuesi do të punojë, për të arritur në përfundim të vitit shkollor, në këtë lëndë.

Mësuesit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës të përcaktuara në program, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara.

Në programin e gjuhës ruse afërsisht 70% e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe 30 % e tyre për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Shpërndarja e orëve mësimore

Gjuha ruse për klasën e 11-të zhvillohet me 4 orë mësimore në javë:

(36 javë x 4 orë =144 orë mësimore vjetore)

Komunikim dhe formim kulturor zë 101 orë, të cilat ndahen në 70 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 50 orë do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 20 orë do të shërbejnë për përfundimin dhe përpunimin e njohurive p.sh: përfundimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime rreth këtij informacioni dhe 31 orë për aktet dhe funksionet e komunikimit (nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 21 orë mësimore do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e tyre d.m.th 10 orë mësimore do të përdoren për përpunimin e njohurive). Në këto orë mësimore mësuesi përpunon njohuritë për integrimin tërësor të lëndës dhe jep detyra, ku të pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas aftësive dhe objektivave në një kapitull, apo grup temash.

Orët e përgjithshme për përpunimin e lëndës janë 43 orë nga të cilat (6 orë mund të përdoren për përsëritjen dhe 10 orë për vlerësimin me shkrim të atyre që kanë përfunduar nxënësit gjatë procesit të nxënies).

Formimi gjuhësor zë 43 orë mësimore: Këto orë janë kryesisht orë, ku mësuesi shtjellon në bashkëveprim me nxënësit njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore-gramatikore e leksikore (nga këto 70% e tyre, që përbëjnë 30 orë do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30 % , që përbëjnë 13 orë mësimore do të shërbejnë për rimirjen, përpunimin dhe përfundimin e tyre)

Përmbajtja mësimore e lëndës të gjuhës ruse synon konsolidimin e nivelit A2.

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen e njohurive, thellimin dhe avancimin e tyre;
- testimin e njohurive të marra,
- punë të pavarura të nxënësve si (ese, relacion shkencor mbi nje teme te dhëne etj),
- testimin e nxënësve në kapituj në semester dhe fund viti.

Strategjitë e të nxënit për zhvillimin e aftësive:

Të dëgjuarit

- Të dëgjojë tekstin , duke plotësuar boshllëqet në tekstin e shkruar.
- Të krahasojë tekstin e shkruar me atë të dëgjuar.
- Të bëjë pyetje –përgjigje dhe të japë shkurtimisht përmbajtjen e tekstit të dëgjuar.
- Të kuptojë shprehje dhe fjalë në lidhje me fushat e prioritetit imediat.(p.sh:informacion personal, familjar, blerje, gjeografi lokale).
- Të dallojë temën e një diskutimi, që zhvillohet në praninë e tij, gjithmonë nëse shqiptimi është i qartë dhe i ngadaltë.

Të folurit

Për të zhvilluar aftësinë e të folurit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të tregojë se çfarë dëshiron ose jo.
- Të diskutojë për çështje të përditshme në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë.
- Të japë mendimin e tij për një temë, që diskutohet mes miqsh.
- Të pyesë bashkëbiseduesin për të bërë të qartë atë, që është thënë.
- Të bëjë bisedë të ndërsjelltë me bashkëbiseduesin.

Të lexuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të lexuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të lexojë një tekst dhe të nxjerrë kuptimin e tij.
- Të lexojë tekstin për herë të dytë që të hamëndësojë kuptimin e fjalëve të panjohura.
- Të jetë i aftë të ndjekë në mënyrë logjike ngjarjet, që pëshkruhen në tekst, të dallojë faktet e veçanta gjatë përshkrimeve, replikave etj.
- Të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të mendojë për përgjigjet e mundshme.
- Të hyjë në bisedë në lidhje me temën e përcaktuar të një teksti.

Të shkruarit

Për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të shkruajë shënime të shkurtra për gjërat më të nevojshme.
- Të shkruajë udhëzime të hollësishme personale.
- Të hartojë tregime të shkurtra mbi bazën e një materiali të njohur.
- Të planifikojë paragrafët duke shkruar idenë kryesore të secilit paragraf.
- Të këmbëjë punën e tij/saj me atë të shokut/shoqes.

Parime për zbatimin e program

Vendosja e nxënës/it,-es në qëndër të vëmendjes

Programi merr parasysh nxënës/in,-en, njohuritë e tij/saj, aftësitë e grup-moshës, interesat, talentin dhe përvojat vetjake. Kjo reflektohet, së pari, në përzgjedhjen e temave që trajtohen, së dyti, në përdorimin e strategjive që e nxisin nxënës/in,-en të veprojnë me gjuhën, së treti, në përfshirjen e tij në vlerësimin dhe vetëvlerësimin e dijeve të përfuara.

Krijimi i mjedisit të të nxënës

Krijimi i një mjedisi shkollor fizik, emocional, sfidues dhe jofrenues për procesin mësimor, ku nxënës/i,-ja ndjehet i/e sigurt, mundëson një mësimdhënie/nxënie që plotëson ndjeshëm nevojat dhe objektivat e përcaktuara më parë.

Organizimi i klasës

Mësues/i,-ja përdor mënyra të ndryshme të organizimit të klasës, që krijojnë e ruajnë një mjedis mbështetës dhe rrisin motivimin e nxënësve. Organizimi i mësimin mundëson punën në grupe dhe nxit lirshmërinë e nxënësve. Atyre u krijohen mundësi ose lehtësi për të eksploruar në gjuhë, për të eksperimentuar në të, për ta përdorur atë në përputhje me nevojat e tyre. Atmosfera e klasës është mbështetje dhe respekt për përgjigjen e nxënësit, si nga mësuesi, ashtu edhe nga nxënësit e tjerë. Nxënës/i,-ja ndërkohë mëson edhe nga shokët e tij. Herë pas here, nxënës/i,-ja punon në mënyrë të pavarur, duke menduar vetë, për zgjidhjen e një problemi.

Të mësuarit bashkëveprues

Nxënës/i,-ja gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh nxitet të punojë së bashku me të tjerët. Detyrat e përbashkëta u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur me njëri-tjetrin, ndihmojnë të folurit e rrjedhshëm dhe formojnë shkathtësi sociale. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe ndihmon, gjithashtu, në shoqërimin e nxënësve, i bën ata bashkëveprues me njëri-tjetrin dhe me mësuesit, nxit tolerancën ndaj

mendimit të tjetrit, si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike, për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

Përdorimi i gjuhës në klasë

Gjuha ruse është mbizotëruese gjatë orës së mësimi. Mësues/i,-ja, që është nxitësi dhe mbështetësi kryesor i përdorimit të gjuhës ruse në klasë, minimizon përdorimin e gjuhës amtare, të cilën e përdor vetëm kur është e domosdoshme, në funksion të shpjegimit të një kuptimi gramatikor a leksikor, të një ballafaqimi ndërgjuhësor, të një përkthimi pedagogjik etj.

Të mësuarit e gramatikës

Nevojat e veçanta për komunikim mbështeten në gramatikën komunikuese. Nxënësit e mësojnë gramatikën në shërbim të komunikimit. Në këtë nivel jepet një sasi e vogël rregullash gramatikore për t'u mësuar, gjithmonë në mënyrë të tillë që nxënësit të mund të përdorin format gramatikore për qëllime komunikimi. Gramatika jepet dhe mësohet në mënyrë induktive, nëpërmjet materialeve autentike. Nxënësit, gjatë të gjithë procesit të të nxënës, ekspozohen ndaj strukturave dhe formave të reja gramatikore.

Qortimi i gabimeve

Gabimet duhet të qortohen, por kjo në kohën dhe vendin e duhur. Vërejtjet, këshillat dhe qortimet e mësuesit, të shokëve ose dhe të vetë nxënësit ndihmojnë për të nxitur vetëbesimin dhe vërtetësinë. Qortimi pa kriter mund të çojë në frenimin e iniciativës, në heqjen e dëshirës për të folur, në demotivimin, madje mund të rrezikojë edhe ecurinë e mëtejshme të mësimi. Mësues/i,-ja ndërhyt me takt, dhe, duke përdorur forma të larmishme, qorton më shpesh, kur nxënësit praktikojnë strukturat gramatikore dhe më rrallë, kur nxënësit janë duke punuar në grup, kur janë duke debatuar ose duke diskutuar për tema të ndryshme.

Puna e diferencuar me nxënësit.

Më qëllim që metodat e mësimdhënies/nxënies, parimet dhe strategjitë mbi të cilat realizohen këto metoda të kenë arritje sipas standardeve të përcaktuara, mësues/i,-ja planifikon punën e diferencuar me nxënësit. Duhet të pranojmë se niveli i formimit të aftësive të nxënësve, që i nënshtrohen programit të gjuhës ruse të klasës 11-të, nuk është i njëjtë për të gjithë nxënësit. Arritja e rezultateve të kërkuara nga programi për të gjithë nxënësit kërkon që mësuesi të marrë parasysh nivelet e ndryshme që ekzistojnë në klasë. Kjo gjë ndodh për arsye objektive ose subjektive. Prandaj, mësues/i,-ja planifikon punën e tij të diferencuar në lidhje me metodat e mësimdhënies, me ecurinë e nxënësve gjatë gjithë procesit mësimor, si dhe me format e ndryshme të vlerësimit.

Mësues/i,-ja njihet mirë që në fillim me përbërjen e klasës së tij dhe me problemet që kanë nxënësit. Mësuesit kanë të bëjnë me adoleshentë dhe, për këtë arsye, ata ndeshen

edhe me shumë probleme të moshës së tyre, si: temperament impulsiv, vrazhdësi në komunikim, ndonjëherë agresivitet, dorëzim apo heqje dorë para një detyre të dhënë etj.

Me qëllim që t'i tërheqë të gjithë nxënësit në mësim, mësues/i,-ja duhet të përdorë disa *teknika*, si:

- të ketë vullnetin dhe dëshirën për t'i dëgjuar dhe për t'u dhënë përgjigje nxënësve;
- të ndjekë klasën në çdo hap, brenda dhe jashtë saj;
- të ndajë përgjegjësitë dhe atëherë kur duhet për çështje vendimmarrjeje, detyra shtëpie apo klase, detyra me shkrim etj.;
- të japë vazhdimisht përshkrime të punës së nxënësve;
- të kërkojë prej tyre vlerësime të punës së tij, me qëllim që të reflektojë ndaj dobësive.

Nxënësit kanë nevojë për një siguri profesionale dhe njerëzore në klasë, prandaj mësues/i,-ja përdor metoda të larmishme dhe gjithëpërfshirëse demokratike, duke siguruar një mjedis të rregullt brenda normave dhe rregullave të shkollës.

Më poshtë janë dhënë disa *sugjerime*, se si mësues/i,-ja mund të nxisë nxënësit të punojnë në klasë dhe jashtë saj:

- shmang çdo gjë që nuk i përshtatet moshës së nxënësve;
- zgjedh materiale për mësim në përputhje me kërkesat dhe standardet e programit mësimor;
- nëse diçka nuk ecën në klasë, përpiqet ta mënjanojë dhe të përdorë punën në grup ose, për individë të veçantë, punën individuale;
- përdor ushtrime që kërkojnë pjesëmarrje aktive, duke nxitur edhe nxënësit me dije jo të plota të përfshihen në to;
- shmang ushtrime që i vënë këta nxënës në vështirësi dhe i zënë ngushtë;
- motivon nxënësin edhe për një detyrë fare të vogël që ka bërë, me qëllim që të rritet dëshira dhe përgjegjësia për mësimin e gjuhës së huaj;
- nuk i paragjykon nxënësit, por përkundrazi u jep ushtrime ,që kërkojnë vëmendje dhe punë.

6.VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor.Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi i nxënësit duhet të jetë sa më objektiv dhe i matshëm. Asgjë nuk është më nxitëse , sesa sukcesi i arritur, duke u përballur me gjëndjen reale, në të cilën ndodhet një nxënës.

Mësues/i,-ja monitoron dhe vlerëson detyrat, duke përcaktuar objektiva të qartë.

Mësue/i,-ja përdor vetë dhe ndihmon edhe nxënësit që të përdorin një larmi mënyrash vlerësimi .

Vlerësimi mund të organizohet në disa forma:

Vlerësimi i dijeve (ose i niveleve), ku përfshihet vlerësimi i objektivave specifike. Ky vlerësim ka lidhje me atë çka është mësuar gjatë një jave, muaji, ose semestri, pra me punën që është bërë me tekstin dhe programin. Vlerësimi i dijes është i bazuar në orën e mësimit. Kështu ai i përgjigjet një vështrimi të brëndshëm.

Vlerësimi i kapaciteteve (ose i zbatimit të aftësive ose i performancës), që është vlerësimi i asaj çka nxënësit mund të bëjnë ose dinë, në raport me zbatimin e saj në jetën e përditshme. Ky lloj vlerësimi është pozitiv, për faktin se është më afër përvojës së nxënësit dhe i lejon secilit të pozicionohet aty ku e meriton, pasi rezultatet janë më se të dukshme.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: reciton, interpreton, prodhon një ese ,a shkrim tjetër etj.

Vlerësimi me shkrim dhe me gojë duhet të mbajë parasysh komponentët e mëposhtëm:

Vlerësimi formues, me anë të të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënësi në formimin e tij gjuhësor, në përputhje me objektivat e caktuar.

Vlerësimi diagnostikues, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe përvetësimin të materialit gjuhësor të dhënë më parë. Ai jep informacion, gjithashtu, për efektivitetin e të nxënësit dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/nxënies.

Vlerësimi i planifikuar, mbi bazën e realizimit të objektivave të nënlinjave, pra në bazë kapitulli. Ky vlerësim bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës.

Vlerësimi motivues, ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënësit për mësimin e gjuhës ruse. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor, Mësues/I,-ja realizon këtë lloj vlerësimi , duke gjetur shprehjet e duhura motivuese si psh: mirë, shumë mirë etj dhe duke përdorur materiale, që nxisin vlerësimin motivues të nxënësit. Psh. përgatitja e dosjes së arritjeve të nxënësit si pjesë e Portofolit Evropian të Gjuhëve, ku ai vendos çertifikata, provime, projekte, dëshmi etj., që provojnë ecurinë e tij në gjuhë.

Vlerësimi përfundimtar

Në përfundim të semestrit të parë, për cdo nxënës/e dhe lëndë përllogaritet nota semestrale dhe në përfundim të vitit shkollor, nota vjetore. Nota e semestrit të parë dhe ajo vjetore përllogariten duke pasur si të dhëna fillestare të gjitha notat e nxënës/it,-es të shënuara në regjistër. Notat gjatë vitit shkollor nuk kanë të njëjtën peshë në njehsimin e notës semestrale dhe asaj vjetore.

Duhet treguar kujdes që para testimit duhet bërë një model, që t`u tregohet nxënësve se si do të bëhet testimi.

- Caktohen më parë qëllimet e testimit , për të kaluar më pas në zhvillimin e tij.
- Vlerësimi mund të jetë individual ose në grup.

- Në rastet kur testet hartohen me pyetje të llojeve të ndryshme, ato grupohen sipas llojit të tyre p.sh. pyetje me zgjedhje të shumfishtë bashkë, ato me çiftim bashkë e kështu me radhë.
- Është mirë që pyetjet në test të renditen sipas shkallës së vështirësisë së tyre. Zakonisht në një test, (p.sh. në fund të një kapitulli) kërkohet që 30% të pyetjeve të jenë të nivelit të parë, 50% të nivelit të dytë dhe 20% të nivelit të tretë. Numri i pyetjeve në test varet nga ajo çka duhet testuar (një mësim, kapitull, apo një koncept).

Disa udhëzime për vlerësimin.

Është e domosdoshme që mësues/i,-ja të mos përdorë vetëm një formë vlerësimi, por larmi formash. Ato duhet t`u krijojnë nxënësve mundësi të vlerësohen në atë mënyrë që është e përshtatshme për çdo individ. Kështu, p.sh. një nxënës/e përgjigjet më mirë me gojë, një tjetër me shkrim, njëri i shpreh bukur dhe me emocion mendimet në një pyetje të hapur, një tjetër jo, etj.

Vlerësimet e përfundimeve të nxënësve të trajtohen me kompetencë e jo si mesatare aritmetike e notave të vlerësimit formues.

Të kihet parasysh që përparimi i nxënës/it,-es, si dhe një gjykim përmbledhës në përfundim të periudhës bazuar në objektiva, përbën vlerësimin përfundimtar. Vonesat e dhënies së përfundimeve të vlerësimit dhe analiza e tyre nga mësues/i,-ja e ulin shumë vlerën e korigjimit të gabimeve.

Shënimet të jenë të thjeshta, por të pasura. Është e domosdoshme që përveç regjistrit të klasës, mësues/i,-ja të mbajë shënime të tjera për punën e çdo nxënës/i,-e dhe të krijojë një portofol të punës së tij me nxënësit. Ato ndihmojnë në njohjen dhe në vlerësimin e arritjeve, në diagnostikimin e në riparimin e vështirësive dhe lehtësojnë vlerësimet përmbledhëse.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë si dhe ndihmon nxënësit dhe së bashku zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Metodat e vlerësimit të përdorura në gjuhë të huaj do të përfshijnë:

- teste me shkrim, për të kontrolluar arritjet e nxënësve në lidhje me objektivat e programit,
- monitorimin e punës në grup të nxënësve,
- punët eksperimentale, raportet e punës,
- projektet, prezantimet e kërkimeve.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e nxënësve në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe me rrugë elektronike. Mësues/i,-ja vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të zhvilluara vetë ose në grup. Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjëra orësh mësimore, që përbëhen nga një apo disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të nderlidhura të të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai/ajo përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet disa minutëshe për një objektivi të veçantë të të nxënësve, tek ajo njëorëshe. Planifikohen teste me alternativa ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Portofoli i nxënës/it,-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor për gjuhën ruse. Portofoli i nxënës/it,-es mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënës/i,-ja, ndërsa mësues/i,-ja rekomandon.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti sipas detyrave të tij/saj në grup.

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi nuk duhet të përdoret si zëvendësim i vlerësimit të bërë nga mësuesi.

Vetëvlerësimi ndihmon:

- për të njohur vetveten
- për të qartësuar objektivat mësimore,
- për t'i treguar çdo nxënës/i,-se, se ka përparuar në mësim,
- për t'i treguar secilit anët e forta dhe të dobëta të tij,
- për të zhvilluar aftësitë për vetëvlerësim,
- për të krijuar një qëndrim real dhe objektiv ndaj vetëvlerësimit.

Ndër teknikat e vetëvlerësimit, që mund të përdoren në klasë mund të përmëndim:

- Vlerësimi nga secili nxënës i punimeve ose i mendimeve të nxënësve të tjerë të grupit apo klasës.
- Vlerësime nga grupe nxënësish, vlerësimi nga juria e klasës.
- Vlerësimi vetjak i secilit nxënës për vetveten.

Si instrumente të vetëvlerësimit, krahas të tjerash, përdoren edhe pyetësorët, tabelogramet, grafikët, regjistrimet në magnetofon, dosja e nxënësit, etj.

